

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN/ Departamenti i përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me sekretaren juridike Igballe Azemi, në çështjen penale ndaj të akuzuarit R.SH. me vendbanim në fsh ... K. ... me av. S.R. nga ..., për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 8 e 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.Nr.467/2017 të datës 31.03.2017, të cilën e përfaqëson prokurori Leonora Shemsiu-Kadriu pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar më datë 26.06.2018 mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri **R.SH.**, nga i ati C., e ëma T., e lindur B. i lindur më dt. ... në ... me vendbanim në fshatin ... K. ..., ku dhe jeton, ka të kryer fakultetin e Farmaceutikes, i martuar baba i dy fëmijëve, punon në barnatore në Ranilluk i gjendjes ekonomike të mesme, serb, shtetas i R. Kosovës, më parë i pa gjykuar dhe nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datë 14.03.2017 rreth orës 16:25 min në magjistralen Bujanoc-Gjilan, derisa i pandehuri ishte në lëvizje me automjetin e markës “Dacia Sandero” 1.4 me tabela të regjistrimit ..., ngjyrë hiri metalike, ka rrezikuar trafikun publik duke vu në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre, në atë mënyrë që duke bërë tejkalim të pa sigurt e në kundërshtim me nenin 71 të Ligjit për sigurinë në Komunikacionin Rrugor, me të arritur për ballë restorant “ ... ” me pjesën e përparme të automjetit e godet në pjesën e përparme automjetin e markës “VW Golf” me tabela të regjistrimit ..., në të cilin kishte qenë duke drejtuar Q.I., e cila ishte duke lëvizur nga drejtimi i kundërt Gjilan-Bujanovc, me ç rast përveç dëmeve materiale në dyja automjetet, lëndime të rënda trupore pësojnë tani të dëmtuarit F.H. dhe T.SH., ndërsa të dëmtuarit Q.I. dhe C.Sh., pësojnë lëndime të lehta trupore, të cilët për shkak të lëndimeve të pësuar detyrohen të kërkojnë ndihmën mjekësore në Emergjencën e Spitalit Regjional në Gjilan, sipas raporteve mjekësore ..., ..., ... të dt.14.03.2017.

Me çka ka kryer veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 8 e 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s
Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 41, 45, 47, 73, 75 dhe 83 të KPRK, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të akuzuarin,

E G J Y K O N

I. Të akuzuarit **R.Sh.** i shqiptohet denim me burgim në kohëzgjatje prej 150 (njëqind e pesë dhjetë) ditësh, dënimi i cili do të ekzekutohet pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.

II. Në bazë të nenit 47 të KP-s dhe me pëlqimin e të pandehurit R.Sh. dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 150 (njëqindë e pesë dhjetë) ditë **zëvendësohet** në dënimi me gjobë në shumë prej 1500 € (njëmijë e pesë qind euro). nëse i pandehuri R.Sh. nuk e paguan dënimin me gjobë, dënimi me gjobë revokohet dhe do të ekzekutohet dënimi me 150 ditë burg.

III. Në bazë të nenit 62 paragrafi 1 e 2 nën paragrafi 2,4 të KP-s, të pandehurit R.Sh. i shqiptohet denimi plotësues **NDALIMI I DREJTIMIT TË AUTOMJETIT** në kohëzgjatje prej 1 viti pas ekzekutimit të denimit.

IV. Të dëmtuarit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike të udhëzohen në kontest juridiko civil.

V. Obligohet i akuzuari që veç e veç të paguajnë paushallin gjyqësor në shumën prej nga 30.00 € (tridhjetë euro) në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm.

VI. Të akuzuarit i shqiptohet taksa për kompensimin e viktimave të krimit, në shumën prej 30.00 € (tridhjetë euro), në bazë të nenit 39 paragrafi 3, nën paragrafi 1.3 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit

A R S Y E T I M

1. Rrjedha e çështjes dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Themelore në Gjiilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 31.03.2017, ka ngritur aktakuzën PP.II.Nr.467/2017, kundër të akuzuarit R.Sh. nga fsh ... K. ..., për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 8 e 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s .Në shqyrtimin fillestar dhe publik të datës 26.06.2018 prezent ishin prokurorja e shtetit Leonora Shemsiu-Kadriu, i pandehuri R.Sh. me mbrojtësit e tij av. S.R. nga ... me autorizim në shkresat e lëndes , të dëmtuarit Q.I. dhe F.H.

2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të prokurorit të shtetit, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit R.Sh. nga fsh. ... K. ..., për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar as i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojnë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike, duke u bazuar në format e kualifikuara të kësaj veprë, ekziston fakti se i pandehuri R.Sh., nga fsh. ... K.P. ka kryer veprën penale, Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 8 e 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s si dhe ka shkelur dispozitën ligjore nga neni 71 të Ligjit për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor në kohën, vendin, dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Gjykata, pas dëgjimit të deklaratave të palëve lidhur me dënimin, e ka shpallur fajtor të akuzuarin R.SH., nga fsh ... K. ... për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 8 e 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s dhe nenin 71 të Ligjit për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale dhe se për të njëjtën është dhe penalisht përgjegjës.

Në bazë të nenit 378 paragrafi 8 dhe 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s, Rrezikim i trafikut publik konsiderohet:

1.Kushdo që shkel ligjin mbi trafikun publik apo transportin rrugor dhe rrezikon jetën e njerëzve apo pasurinë dhe me këtë i shkakton dikujt lëndim të lehtë trupor ose dëm pasuror, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

6.Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

8.Nëse vepra penale nga paragrafi 6. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor ose dëm pasuror në vlerë prej njëzetmijë (20.000) Euro apo më shumë, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenit 73, 74, 75 dhe 76 të KPRK-s, ka vlerësuar se duhet të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe të akuzuarit R.SH., nga fsh ... K. ... i shqiptohet dënim me 150 ditë burg i cili dënim zëvendësohet me dënim me gjobë në shumën prej 1500 euro, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat ky dënim do të jetë dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat ky dënim do të jetë dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale, ashtu që për të akuzuarin R.SH., si rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marrë faktin se i akuzuari ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, dhe se i njëjti është penduar më parë nuk ka kryer vepra tjera penale dhe i ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, ndërsa si rrethana rënduese gjykata gjeti dëmin e shkaktuar të dëmtuarve si dhe lëndime trupore të dëmtuarave.

6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së gjyqtarit të vetëm gjykues dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit R.SH., nga fsh ... K. ... duke marr parasysh rrethanat e përmendura më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit.

Gjyqtari po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Palët e dëmtuara, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest juridiko civil.

8. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare e të pandehurve, gjykata, duke u bazuar nënin 453 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurit ti detyrojë për të paguar shpenzimet e procedurës penale, dhe paushallin gjyqësor, si dhe taksën për viktime në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr. 347/2017, Me datë 26.06.2018

Sekretarja Juridike

Igballe Azemi d.v

Gjyqtari

Behar Ymeri d.v

KËSHILLA JURIDIKE;Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë / Departamentit të përgjithshëm në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimi e të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate